Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

# Projektligjin “Për Sektorin Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimin e Ujrave të Ndotura Urbane”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Postuar më: 30.10.2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektligjin “Për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimin e Ujrave të Ndotura Urbane”. Ky projektligj ka si qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor që siguron kushtet optimale për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në të gjithë vendin.

Ky Projektligj gjithashtu ka si objektiv kryesor ndërtimin e kornizës institucionale, në nivel kombëtar e vendor, ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion në kuadrin e përmbushjes së funksioneve politikëbërëse, rregullatore, menaxheriale dhe operacionale, ngritjen e mekanizmave që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore në veçanti dhe krijimin e mekanizmave që promovojnë ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, si dhe promovimin e mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

Përsa më sipër, ftohen grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

**Dokumenta:**

- Projektligji
- Relacioni
- Raporti i Vleresimit te Ndikimit

## Diskutimet